

MANUALI UDHËZUES

“MBI RREGULLAT E ORIGJINËS JO-PREFERENCIALE”

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	3
1.1	Ndryshimi midis statusit doganor dhe origjinës	3
1.2	Fusha e zbatimit të rregullave të origjinës jo-preferenciale	4
2.	Çlirimi për qarkullim të lirë i mallrave.....	4
2.1.	Konceptet themelore për përcaktimin e origjinës jo-preferenciale:.....	4
2.1.1.	Në prodhimin e produktit është i përfshirë vetëm një vend	4-5
2.1.2.	Në prodhimin e produktit janë përfshirë dy ose më shumë vende.....	5-8
2.2.	Përcaktimi i origjinës ku dy ose më shumë vende janë të përfshira në prodhim.....	8
2.2.1.	Përcaktimi i origjinës për produktet të cilat janë të përfshira në Aneksin 22-01 të Shtojcës A, të DZKD	8-12
2.2.2.	Përcaktimi i origjinës për produktet që nuk janë përfshirë në Aneksin 22-01 ,të Shtojcës A, të DZKD	132
2.3.	Deklarimi në deklaratën e origjinës dhe provën e origjinës	133
2.3.1.	Certifikata e origjinës për produktet shqiptare në eksport dhe bashkëpunimi administrativ	133
2.3.2.	Kontrolli i origjinës jo-preferenciale për produktet që nuk i nënshtrohen rregullimeve të veçanta jo-preferenciale të importit	143-14
2.3.3.	Verifikimi i origjinës jo-preferenciale për produktet të cilat janë subjekt i marrëveshjeve të veçanta jo-preferenciale të importit (pikat 1 dhe 2, të nenit 61 të KD)	15
5		
2.3.4.	Deklarimi i pasaktë i origjinës jo-preferenciale në deklaratën për çlirim në qarkullim të lirë	15
3.	Eksporti i mallrave.....	166
4.	Dispozita të fundit	166
ANEKSI 1	17
Informacion që mund të kërkohet nga autoritetet doganore		17
ANEKSI 22-01, i Shtojcës A, të DZKD		18
Shënime hyrëse dhe lista e operacioneve thelbësore të punimit ose përpunimit të origjinës jo-preferenciale		18
ANEKSI 22-09, i Shtojcës B, të DZKD		18
Certifikata e Origjinës.....		18

ANEKSI 22-14, i Shtojcës B, të DZKDjustifikimi ekonomik	18
Certifikata e origjinës për produktet që janë objekt i marrëveshjeve/rregullimeve të veçanta të importit të origjinës jo-preferenciale	18

Shkurtime	Përcaktime
KD	Ligji Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
DZKD	VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar
IDT	Informacion i Detyrues i Tarifës
SH	Sistemi i Harmonizuar
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
NK	Nomenklatura e Kombinuar
CC	Ndryshim në kapitull
CTH	Ndryshim në kreun tarifor
CTSH	Ndryshim në nënkreun tarifor
IDO	Informacion Detyrues i Origjinës
CTSHS	Ndryshim në ndarje të nënkreut tarifor

1. Hyrje

Qëllimi i këtij Manuali është që t'ju ofrojë asistencë operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve doganore mbi kuptimin dhe zbatimin e rregullave për përcaktimin e origjinës jo-preferenciale të mallrave në Shqipëri.

Origjina është *kombësia “ekonomike”* e mallrave që përdoren në tregti. Trajtimi doganor në lidhje me çlirimin për qarkullim të lirë të mallrave përcaktohet nga tre elementë: *klasifikimi tarifor, vlera doganore dhe origjina e mallrave.*

Ka dy lloje të origjinës: **origjina preferenciale** dhe **origjina jo-preferenciale**.

Origjina preferenciale u jepet mallrave nga vendet e veçanta kur ato përmbushin rregullat e origjinës të parashikuara në marrëveshjet përkatëse preferenciale. Në këtë rast, mallrat mund të përfitojnë nga një reduktim apo heqje e taksës doganore. Duhet të theksohet se jo të gjitha produktet kanë domosdoshmërisht origjinë preferenciale.

Rregullat e origjinës jo-preferenciale përdoren për zbatimin e të gjitha llojeve të masave jo-preferenciale të politikës tregtare, si p.sh. detyrimet anti-dumping dhe detyrimet kundërbalancuese, embargot e tregtisë, masat mbrojtëse, kërkesat e shënimit të origjinës, kufizimet sasiore ose kuotat tarifore, prokurimet qeveritare dhe statistikat tregtare.

Origjina jo-preferenciale përftohet kur mallrat janë “*tërësisht të përftuara*” në një vend, ose kur prodhimi i të tyre ka përfshirë dy ose më shumë vende, quhen me origjinë nga vendi ku këto mallra i janë nënshtruar trajtimit ose përpunimit të fundit, thelbësor, të justifikuar ekonomikisht, i cili është kryer në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim dhe si rezultat i të cilit është prodhuar një produkt i ri, ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit.

Çdo produkt domosdoshmërisht ka origjinë jo-preferenciale, e cila mund të jetë e ndryshme nga origjina preferenciale.

Në vijim të këtij Manuali udhëzues, fjala ‘origjinë’ i referohet origjinës jo-preferenciale.

1.1 Ndryshimi midis statusit doganor dhe origjinës

‘Statusi doganor i mallrave’ dhe ‘origjina e mallrave’ janë dy koncepte të ndryshme, që shërbejnë për qëllime të ndryshme.

Statusi doganor nënkupton statusin e mallrave si mallra shqiptare ose mallra jo-shqiptare, sipas përcaktimit në pikën 22, të nenit 6 të KD. Ky status është i pavarur nga origjina e mallrave. Statusi doganor nuk ndikon në origjinën e mallrave.

Rrjedhimisht, për mallrat që janë me origjinë nga Shqipëria, të cilat çlirohen për qarkullim të lirë në Shqipëri, detyrimet e aplikueshme duhet të paguhen kur mallrat kanë statusin doganor të mallrave jo-shqiptare. Statusi doganor shqiptar merret pas përfundimit të procedurave për çlirimin në qarkullim të lirë dhe pagesës së detyrimeve të aplikueshme.

1.2 Fusha e zbatimit të rregullave të origjinës jo-preferenciale

Rregullat e origjinës jo-preferenciale zbatohen për mallrat e deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë në Shqipëri me qëllim zbatimin e Tarifës Doganore, me përjashtim të rasteve kur ka të bëjë me masat tarifore preferenciale. Ato përdoren gjithashtu për zbatimin e masave të tjera të parashikuara në dispozita që rregullojnë fusha specifike që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave, si masat anti-dumping ose kriteret e markave tregtare.

Rregullat e origjinës jo-preferenciale të aplikuara nga Shqipëria, si anëtare e OBT-së janë në përputhje me parimet e përcaktuara në Marrëveshjen për Rregullat e Origjinës (OBT-GATT 1994, i bashkëngjitur aktit final të nënshkruar në Marrakesh në 15 prill 1994).

2. Çlirimi për qarkullim të lirë i mallrave

2.1. Konceptet themelore për përcaktimin e origjinës jo-preferenciale:

Neni 60 i KD dhe nenet 98-103 të DZKD

Që të përcaktohet origjina e një produkti është e nevojshme të njihet klasifikimi tarifor. Në të vërtetë, rregulli i origjinës që do të zbatohet varet nga linja tarifore. Nëse ka dyshime për klasifikimin tarifor rekomandohet që operatori ekonomik (importuesi) të aplikojë për vendim IDT.

Për të përcaktuar origjinën jo-preferenciale të një produkti, mund të ketë dy situata. Këto dy situata, të cilat duhet të dallohen dhe janë si vijon:

- është vetëm një vend i përfshirë në prodhimin e produktit, duke përfshirë materialet e inputit;
- janë dy ose më shumë vende të përfshira në prodhimin e produktit.

2.1.1. Situata 1 - Në prodhimin e produktit është i përfshirë vetëm një vend

Kur në prodhimin e produktit përfshihet vetëm një vend atëherë zbatohet pika 1, e nenit 60, të KD. Ky nen parashikon që *“mallrat tërësisht të përfuara në një vend apo territor të vetëm do të konsiderohen se kanë origjinën e tyre nga ai vend apo territor”*.

Neni 98, i DZKD specifikon konceptin e “mallrave tërësisht të përfuara”. Ky nen rendit një listë shterruese të mallrave që do të konsiderohen tërësisht të përfuara në një vend apo territor të vetëm:

- a) Produkte minerale të nxjerra brenda atij vendi apo territori;
- b) Produktet bimore të korrura atje;
- c) Kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;
- ç) Produktet e prejardhura nga kafshët e gjalla të rritura atje;
- d) Produktet e gjahut ose të peshkimit të zëna atje;

dh) Produktet e peshkimit si dhe produktet e tjera të marra nga anijet/barkat e regjistruara në vendin ose territorin në fjalë dhe që mbajnë flamurin e atij vendi apo territori jashtë ujërave territoriale të secilit vend;

e) Mallrat e përftuara ose të prodhuara në bordin e anijeve-fabrikë nga produktet e përmendura në shkronjën “dh”, me origjinë nga ai vend apo territor, me kusht që këto anije-fabrikë të jenë të regjistruara në këtë vend ose territor dhe të mbajnë flamurin e tij;

ë) Produktet e marra nga shtrati i detit apo nëntoka poshtë shtratit të detit jashtë ujërave territoriale me kusht që vendi ose territori të ketë të drejtat ekskluzive për shfrytëzimin e shtratit të detit ose të nëntokës;

f) Mbeturinat dhe mbetjet që dalin nga procesi i prodhimit dhe artikujt e përdorur, në qoftë se ato janë mbledhur aty dhe shërbejnë vetëm për rikuperimin e lëndëve të para;

g) Mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar në shkronjat “a” deri “f”.

Për shembull, mollët e mbledhura në Indi kanë origjinë jo-preferenciale indiane, kur ato çlirohen në qarkullim të lirë në Shqipëri.

2.1.2. Situata 2 - Në prodhimin e produktit janë përfshirë dy ose më shumë vende

Kur në prodhimin e produktit janë të përfshira dy ose më shumë vende zbatohet pika 2, e nenit 60 të KD. Ky nen parashikon që *“Mallrat prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend ose territor konsiderohen origjinuese në vendin ose territorin ku kanë pësuar ndryshimin ose përpunimin e tyre të fundit, thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim, e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit”*.

a) “Ndryshimi ose përpunimi i fundit thelbësor”

Ndryshimi ose përpunimi i fundit thelbësor duhet të rezultojë në prodhimin e një produkti të ri, ose të paraqesë një fazë të rëndësishme të prodhimit.

Në praktikë është e nevojshme të kemi informacion për të gjitha materialet e përdorura. Në veçanti, duhet të identifikohen materialet jo-origjinuese të përdorura në vendin e fundit të prodhimit. Në të vërtetë, këto materiale jo-origjinuese duhet të jenë të punuara ose të përpunuara në mënyrë thelbësore për t'i dhënë produktit përfundimtar origjinën jo-preferenciale të vendit të fundit të prodhimit.

Ky kriter duhet të kontrollohet në dy mënyra të ndryshme në varësi të faktit nëse produkti në fjalë përfshihet në Aneksin 22-01, të Shtojcës A, të DZKD (shih pikën 2.2.1) ose nuk përfshihet në këtë Aneks (shih pikën 2.2.2).

b) Justifikimi ekonomik

Është e nevojshme të përcaktohet nëse punimi ose përpunimi i kryer është i justifikuar ekonomikisht.

Në përputhje me nenin 100 të DZKD, kriteri i justifikimit ekonomik nuk respektohet “nëse vërtetohet, në bazë të fakteve në dispozicion, se qëllimi i atij operacioni ishte për të shmangur zbatimin e masave të referuara në nenin 59 të Kodit”.

Zbatimi i këtij kriteri mund të përcaktohet vetëm rast pas rasti, duke marrë parasysh të gjithë elementët e operacioneve të përpunimit në vendin e fundit të prodhimit. Çështja e përputhjes me kriterin “justifikuar ekonomikisht” lind veçanërisht kur janë në fuqi masat anti-dumping.

c) Fabrika e prodhimit

Punimi ose përpunimi i mallrave duhet të kryhet në një ndërmarrje të pajisur për atë qëllim.

ç) Rezultati i transformimit

Punimi ose përpunimi i mallrave duhet të rezultojë në prodhimin e një produkti të ri ose të paraqesë një fazë të rëndësishme të prodhimit.

d) Operacionet minimale

Në përputhje me nenin 101 të DZKD, disa operacione nuk konsiderohen si punime ose përpunime thelbësore, të justifikuara ekonomikisht për qëllime të dhënies së origjinës:

Këto operacione janë:

d/1) Operacionet për të siguruar ruajtjen e produkteve në gjendje të mirë gjatë transportit dhe magazinimit (ajrosja/ventilimi, përhapja, tharja, largimi i pjesëve të dëmtuara dhe operacione të ngjashme) ose operacionet që lehtësojnë dërgesat ose transportin;

d/2) Operacionet e thjeshta që kanë të bëjnë me heqjen e pluhurit, kontrollin apo ekzaminimin, klasifikimin, përputhjen, larjen, prerjen;

d/3) Ndryshimet e paketimit, ndarja dhe grumbullimi i dërgesave, vendosja e thjeshtë në shishe, kanaçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, vendosja në kartona apo dërrasa dhe të gjitha operacionet e tjera të thjeshta të paketimit;

d/4) Vendosja e mallrave në komplete/sete apo grupe, ose nxjerrja e tyre në shitje;

d/5) Vendosja e shenjave/markave, etiketave apo shenjave të tjera të ngjashme e të dallueshme mbi produktet ose mbi paketimin e tyre;

d/6) Bashkimi i thjeshtë i pjesëve të produkteve që përbëjnë një produkt të plotë;

d/7) Ndarja ose ndryshimi i përdorimit;

d/8) Një kombinim i dy ose më shumë operacioneve të përcaktuara në shkronjat “d/1” deri në “d/7”.

Për më tepër, aktivitete të caktuara si p.sh. hartimi i planeve, inspektimi dhe testimi, kontrolli i cilësisë së mallrave nuk duhet të konsiderohen si operacione punimi ose përpunimi.

dh) Trajtimi i aksesorëve, pjesëve të këmbimit ose veglave

dh/1 Aksesorët, pjesët e këmbimit ose veglat e importuara me produktin

Në përputhje me nenin 102, të DZKD, produkte të tilla si makineritë, pajisjet, automjetet ose produkte të tjera shpesh shiten me aksesorë, pjesë këmbimi, vegla ose materiale ilustrimi, p.sh. manuale (materialet e ilustruara përgjithësisht konsiderohen si “aksesorë”), të cilat janë të nevojshme për funksionimin ose mirëmbajtjen e tyre.

Për qëllim të origjinës jo-preferenciale, aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat, që janë pjesë e pajisjeve standarte të mallrave të renditura në Seksionet XVI (Makineri dhe pajisje mekanike, pajisje elektrike, pjesët e tyre, regjistruarit dhe riprodhuesit e tingullit, imazhit televiziv dhe zërit, pjesët dhe plotësuesit e këtyre artikujve); XVII (Mjetet e transportit rrugor, ajror, detar dhe pajisjet shoqëruese të transportit) dhe XVIII (Instrumentet dhe aparatet optike, fotografike, kinematografike, matëse, kontrolli, precizioni, mjeksore ose kirurgjikale, orët e të gjitha llojeve, instrumentet muzikore, pjesët dhe plotësuesit e tyre) të Nomenklaturës së Kombinuar dhe të cilat janë të përfshira në çmimin e mallrave dhe nuk faturohen veçmas, konsiderohen si pjesë të një malli.

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat për përdorim me një makineri, pajisje, aparat ose automjet duhet të konsiderohen se kanë të njëjtën origjinë si makineria, pajisja, aparati ose automjeti, me kusht që ato të importohen së bashku dhe të shiten normalisht me to dhe të korrespondojnë në lloj dhe numër me pajisjen normale të tyre.

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe veglat nuk merren në konsideratë për përcaktimin e origjinës së makinerisë, pajisjes, aparatit ose automjetit me të cilin janë shitur.

dh/2. Pjesët kryesore të këmbimit të importuara për përdorim me një produkt të çliruar tashmë në qarkullim të lirë.

Pjesët kryesore të këmbimit për përdorim me një nga mallrat e listuara në Seksionet XVI, XVII dhe XVIII të Nomenklaturës së Kombinuar, të çliruara më parë në qarkullim të lirë në Shqipëri, konsiderohen se kanë të njëjtën origjinë si këto mallra, nëse përfshirja e pjesëve thelbësore të këmbimit në fazën e prodhimit nuk do kishte ndryshuar origjinën e tyre.

Me pjesë kryesore këmbimi nënkuptohen pjesët të cilat janë:

- a) komponentë, pa të cilët nuk mund të sigurohet funksionimi i duhur i një pjese të pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit që është vënë në qarkullim të lirë apo që është eksportuar më parë; dhe
- b) karakteristikë e këtyre mallrave; dhe
- c) të destinuara për mirëmbajtjen e tyre normale dhe për të zëvendësuar pjesët e të njëjtit lloj të cilat janë dëmtuar apo janë nxjerrë jashtë përdorimit.

e) Elementët neutralë dhe paketimi

e/1- Elementët neutralë:

Faktorët si fabrika ose mjetet e prodhimit të tilla si energjia, karburantet, veglat, makineritë dhe pajisjet që përdoren në procesin e prodhimit të një produkti të cilat nuk përfshihen në produktin përfundimtar quhen elementë neutralë.

Me qëllim që të përcaktohet origjina e mallrave nuk merret parasysh origjina e elementëve të mëposhtme:

- a) energjia elektrike dhe karburanti;
- b) fabrika dhe pajisjet;
- c) makineritë dhe veglat;
- ç) materialet të cilat as nuk hyjnë dhe as nuk janë të destinuara për t'u futur në përbërjen finale të produkteve.

e/2- Paketimi

Kur, në bazë të rregullit të përgjithshëm 5² të Nomenklaturës së Kombinuar materialet e paketimit dhe amballazhet e paketimit konsiderohen si pjesë e produktit për qëllim klasifikimi, ato nuk merren parasysh për qëllim të përcaktimit të origjinës, përveçse kur rregulli në Aneksin 22-01, të Shtojcës A, të DZKD për mallrat në fjalë bazohet në përqindjen e vlerës së shtuar.

2.2. Përcaktimi i origjinës kur në prodhim janë të përfshira dy ose më shumë vende

2.2.1. Përcaktimi i origjinës për produktet që përfshihen në Aneksin 22-01, të Shtojcës A, të DZKD

Neni 99 i DZKD përcakton konceptin e "punimit ose përpunimit të fundit thelbësor". Ky nen parashikon që *"Mallrat e renditura në Aneksin 22-01, të shtojcës A të DZKD, konsiderohen se i janë nënshtruar punimit apo përpunimit të fundit thelbësor, duke rezultuar në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit, në vendin apo territorin në të cilin rregullat e përcaktuara në atë aneks janë plotësuar, apo që identifikohen nga ato rregulla"*.

² Shënim:

Rregulli e përgjithshëm 5 për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar.

Përveç dispozitave të mësipërme, rregullat e mëposhtme do të zbatohen në lidhje me mallrat e përmendura në të:

a) Kutitë e aparateve fotografik, kutitë e instrumenteve muzikorë, kutitë e armëve, kutitë e mjeteve të pikturimit, kutitë e bizhuterive dhe amballazhe të ngjashëm të përshtatur posaçërisht për futjen e një sendi ose grupi sendesh të përshtatshme për përdorim afatgjatë dhe të paraqitura së bashku me artikujt për të cilët janë bërë, do të klasifikohen me këto artikuj, në rast se sipas llojit të tyre normalisht shiten së bashku me to. Sidoqoftë, ky rregull nuk zbatohet për amballazhet që i japin karakterin e tyre thelbësor produktit në tërësi ;

b) sipas rregullit 5 (a), materialet e paketimit dhe kontenerët/mbajtësit e paketimit (Termi "material paketimi" dhe "mbajtës paketimi" do të thotë mbajtës, mbështjellës ose mbështetës të jashtëm ose të brendshëm përveç pajisjeve të transportit (p.sh. termi mbajtës paketimi nuk përfshin amballazhet e përmendura në rregullin 5 (a) të paraqitura së bashku me mallrat që kanë brenda do të klasifikohen me mallra të tillë nëse ato janë të një lloji që zakonisht përdoret për paketimin e mallrave të tilla. Por kjo klauzolë nuk është e detyrueshme kur materiale të tilla paketimi ose amballazhet janë qartësisht të përshtatshme për ripërdorim.

Aneksi 22-01, i shtojcës A, të DZKD zbatohet vetëm për mallrat e specifikuara në të. Për shembull, për Kapitullin 85, rregullat në Aneksin 22-01, zbatohen për ex 8501, 8527, 8528, 8535,...dhe të gjithë krerët e tjerë të renditur në mënyrë specifike në atë kapitull.

Për produktet e tjera të klasifikuara në Kapitullin 85 dhe jo të renditura në mënyrë specifike, si 8502, 8503, rregullat në Aneksin 22-01, nuk zbatohen dhe përcaktimi i origjinës shpjegohet në pikën 2.2.2.

Ekzistojnë dy lloje rregullash në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD: *rregullat bazë dhe rregullat e mbetura.*

Si hap i parë, zbatohen rregullat bazë. Kur një rregull bazë nuk plotësohet, zbatohet një rregull i mbetur për të përcaktuar origjinën e produktit në fjalë. Në të vërtetë, çdo produkt domosdoshmërisht ka një origjinë jo preferenciale.

Shënimet hyrëse të Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD përcaktojnë termat e përdorur zakonisht në këtë Aneks dhe tregojnë se si zbatohen rregullat.

a) Rregullat bazë për produktet të cilat përfshihen në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD

Dy kolonat e para të listës në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut tarifor ose kapitullit të përdorur sipas SH ndërsa kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave për atë kre ose kapitull sipas SH. Për secilën të dhënë në dy kolonat e para, në kolonën 3 jepet një rregull bazë. Kur e dhëna në kolonën e parë paraprihet nga një 'ex', kjo nënkupton që rregulli bazë i dhënë në kolonën 3 zbatohet vetëm për pjesën e atij kreu ose kapitulli, siç përshkruhet në kolonën 2.

Kur në kolonën 1 janë grupuar disa numra krerësh, ose jepet një numër kapitulli, dhe përshkrimi i mallrave në kolonën 2 gjithashtu jepet në terma të përgjithshëm, rregulli bazë në kolonën 3 zbatohet për të gjitha mallrat të cilat, nën SH, janë të klasifikuara në krerët e kapitullit ose në ndonjë nga krerët e grupuar së bashku në kolonën 1.

Kur lista përfshin rregulla të ndryshme që zbatohen për mallra të ndryshëm brenda një kreu, secili nga paragrafët përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut që mbulohet nga rregulli bazë përbri në kolonën 3.

Rregullat bazë mund të vendosen ose në fillim të kapitullit në fjalë ("Rregullat bazë të kapitullit"), ose në tabelën ku renditen rregullat për secilin produkt ("rregullat bazë") dhe këto rregulla mund të zbatohen në mënyrë alternative, sipas zgjedhjes së operatorit ekonomik.

Ekzistojnë dy kategori të rregullave bazë:

- 1) rregulla bazë që identifikojnë vendin, që do të thotë ato që tregojnë drejtpërdrejt vendin e origjinës;
- 2) rregullat bazë që japin origjinën e vendit të fundit të prodhimit, me kusht që kriteri i përcaktuar në rregullin bazë të jetë i përmbushur në atë vënd. Ndër rregullat bazë që japin origjinën në vendin e fundit të prodhimit, bashkë-ekzistojnë tre lloje rregullash:

- ***Kriteri i ndryshimit të kreut tarifor, nënkreut ose kreut të ndarë***

Ndryshimi i kreut tarifor ndodh kur klasifikimi tarifor i produktit përfundimtar është i ndryshëm nga klasifikimi tarifor i materialeve jo-origjinuese që janë përdorur në prodhim. Ka raste kur nga ky rregull mund të ketë përjashtim të një ose disa krerëve specifik (për shembull për kreun 7227 rregulli është “CTH përveç kreut 7228”), ose ndryshimi mund të kushtëzohet nga disa operacione shtesë (për shembull për kreun 7223 rregulli është “CTH, përveç 7221 deri në 7222; ose ndryshimit nga krerët 7221 deri 7222, duke siguruar që materiali është formuar në të ftohtë.”)

- ***Kriteri i përpunimit specifik***

Përpunimi specifik përfshin, për shembull, rregullat e mëposhtme:

* prodhim nga fibrat;

* prodhim nga filli;

* konfeksionim i plotë (do me thënë duhet të kryhen të gjitha operacionet në vijim të prerjes së pëlhurave, ose dhënies së formës së pjesëve të veshjes drejtpërdrejt nga thurja me makinë apo thurja me grep);

* stampim ose ngjyrosje;

* rregulla specifike për mallrat dhe pjesët e prodhuara nga format bazë të metalit.

Termi ‘fibra’ që përdoret në listën e Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD mbulon ‘fibrat natyrore’ dhe “fibrat shtapel të bëra nga njeriu” që përfshihen në kodet e NK 5201 deri 5507 dhe fibrave të një lloji të përdorur për prodhimin e letrës.

Termi ‘fibra natyrore’ përdoret në listën e Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD për t’iu referuar fibrave të ndryshme nga fibrat artificiale ose sintetike dhe është e kufizuar në fazat para se të kryhet tjerja, duke përfshirë mbetjet, dhe nëse nuk specifikohet ndryshe, termi ‘fibra natyre’ përfshin fibrat e krehura ose të gërhanura ose ndryshe të përpunuara, por jo të tjerrura.

Termi ‘fibra natyrale’ përfshin qimet e kalit brenda kodeve të NK 5003, mëndafshin që i përket kodeve të NK 5002 dhe 5003, si edhe fibrat e leshit dhe qimet e holla ose të ashpra të kafshëve të kodeve të NK 5101 deri në 5105, fibrat e pambukut që i përkasin kodeve të NK 5201 deri në 5203, dhe fibrat e tjera bimore të kodeve të NK 5301 deri në 5305.

Shënimi hyrës i pikës 1.4 të Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD thekson që me termin “konfeksionim i plotë” do të nënkuptohen të gjitha operacionet që duhen kryer në vijim të prerjes së pëlhurave, ose dhënies së formës drejtpërdrejt nga thurja. Megjithatë, konfeksionimi nuk duhet konsideruar domosdoshmërisht si i papërfunduar kur një apo më shumë operacione përmbyllëse nuk janë kryer.

Ekziston një rast i veçantë në lidhje me operacionet përfundimtare që lidhen me konfeksionimin e plotë të një produkti. Është e mundur që në operacione të veçanta të prodhimit, kryerja e operacioneve përfundimtare, sidomos në rastin e një kombinimi

operacionesh, është e një rëndësie të tillë që këto operacione duhet të konsiderohen se shkojnë përtej përfundimit të thjeshtë. Në këto raste të veçanta, mosrealizimi i operacioneve përfundimtare do të privojnë konfeksionimin nga natyra e plotë e tij.

- ***Kriteri i vlerës së shtuar***

'Rregulli i vlerës së shtuar X%' do të thotë prodhim ku rritja e vlerës e përftuar si rezultat i punimit ose përpunimit, si dhe nëse është e aplikueshme, inkorporimit të pjesëve origjinuese nga vendi i fabrikimit, paraqet të paktën X% të çmimit të fabrikës/ex-works të produktit. 'X' përfaqëson përqindjen e treguar për çdo kre.

Në përgjithësi duhet të merren parasysh shënimet hyrëse të Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD.

Pika 2.3 e shënimeve hyrëse të Aneksit 22-01 thekson që: "Materialet që kanë marrë statusin e origjinës në një vend do të konsiderohen si materiale origjinuese të atij vendi për qëllim të përcaktimit të origjinës së një malli që i përmban këto materiale, ose të një malli të prodhuar nga këto materiale përmes punimit dhe përpunimit të mëtejshëm në atë vend".

Pika 2.5 e shënimeve hyrëse të Aneksit 22-01 gjithashtu thekson që me qëllim zbatimin e rregullave bazë që kanë të bëjnë me ndryshimin e kreut tarifor, nëse nuk specifikohet ndryshe në ndonjë Kapitull siç është përcaktuar, materialet jo-origjinuese që nuk plotësojnë rregullin bazë nuk duhet të merren në konsideratë, me kusht që vlera totale e këtyre materialeve të mos kalojë 10 % të çmimit të fabrikës/ex-works së mallit.

Përveç kësaj, rregullat bazë paraqesin sasinë minimale të punimit ose përpunimit të kërkuar dhe kryerja e më shumë punimeve apo përpunimeve gjithashtu jep statusin e origjinës; anasjelltas, kryerja e më pak punimeve ose përpunimeve nuk mund të japë origjinën. Kështu, nëse një rregull bazë tregon se materiali jo-origjinues në një nivel të caktuar të prodhimit mund të përdoret, përdorimi i një materiali të tillë në një fazë më të hershme të prodhimit lejohet dhe nuk lejohet përdorimi i një materiali të tillë në një fazë të mëvonshme.

Kur një rregull bazë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë se mund të përdoret një ose më shumë prej materialeve, por jo domdoshmërisht të gjitha materiale.

Shembull

Rregulli bazë për fillin thotë se mund të përdoren fibrat natyrore dhe që ndërmjet materialeve të tjera gjithashtu mund të përdoren edhe materialet kimike. Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren, mund të përdoret njëra, ose tjetra ose të dyja.

Kur rregulli bazë specifikon se produkti duhet të prodhohet nga një material i caktuar, kushti natyrisht nuk e pengon përdorimin e materialeve të tjera të cilat, për shkak të natyrës së tyre të brendshme, nuk mund ta përmbushin rregullin.

b) Justifikimi ekonomik

Në përputhje me nenin 100, paragrafi 2 i DZKD, kur nuk respektohet kriteri i justifikimit ekonomik, zbatohen rregullat e mbetura të Kapitullit.

c) Operacionet minimale

Nëse operacioni që ka çuar në përmbushjen e rregullit është përfshirë në nenin 101 (Operacionet minimale) të DZKD, mallrat nuk do të konsiderohen si origjinuese në vendin në të cilin ka ndodhur operacioni i fundit, pasi ky operacion nuk mund të konsiderohet si thelbësor, edhe nëse rregulli bazë është përmbushur. Në këtë rast zbatohen rregullat e mbetura të Kapitullit.

Shembull

Për Kreun 8206 me përshkrimin “Veglat e dy apo më shumë krerëve 8202 deri 8205, të vendosur në një grup për shitje me pakicë”, rregulli bazë është CTH.

Kur operacioni i vetëm në vendin A do të jetë bashkimi i dy ose më shumë veglave të krerëve 8202 deri 8205 me origjinë nga vendi B në një grup për shitje me pakicë, atëherë ky do të konsiderohet një operacion minimal i cili nuk mund të japë origjinën, pavarësisht nga fakti se rregulli kryesor është përmbushur. Në këtë rast zbatohet rregulli i mbetur i kapitullit, i cili përcakton që “Kur vendi i origjinës nuk mund të përcaktohet nëpërmjet zbatimit të rregullave bazë, vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve, siç është përcaktuar në bazë të vlerës së materialeve”.

Në këtë shembull vendi i origjinës së grupit do të jetë vendi B.

ç) Rregullat e mbetura për produktet e përfshira në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD

Kur një rregull bazë nuk lejon përcaktimin e origjinës jo-preferenciale të mallrave, ose kur përpunimi i bërë nuk është i justifikuar ekonomikisht (neni 100 i DZKD), ose kur operacioni i kryer nuk shkon përtej operacioneve minimale të nenit 101, të DZKD, zbatohen rregullat e mbetura.

Rregulli i mbetur i Kapitullit i përcaktuar në krye të çdo kapitulli thekson se vendi i origjinës së mallrave do të jetë vendi në të cilin origjinon pjesa më e madhe e materialeve. Sipas rastit, rregulli kryesor i pjesës më të madhe bazohet në vlerën ose në peshën e materialeve të përdorura.

Megjithatë, për disa produkte bujqësore (Kapitujt 2, 4, 9, 14, 17, 20 dhe 22), rregullat e mbetura specifike të kapitullit zbatohen për përzierjet e materialeve të zëvendësueshme që kanë përparësi ndaj rregullit të pjesës më të madhe.

Ky rregull zbatohet kur produkti përfundimtar është pjesë e Aneksit 22-01, të shtojcës A, të DZKD, ndërsa materialet e përdorura jo domosdoshmërisht janë pjesë e këtij Aneksi.

Materialet e zëvendësueshme janë materiale të këmbyeshme, ato janë të natyrës ose llojit të tillë që të jenë lirisht të shkëmbyeshme ose të zëvendësueshme, tërësisht ose pjesërisht, për një natyrë ose lloj tjetër të ngjashëm.

Kur asnjë nga materialet e përdorura nuk arrin përqindjen e kërkuar, origjina e përzierjes do të jetë vendi në të cilin është kryer përzierja.

Kur “përzierja” nuk i plotëson kushtet e përkufizimit, zbatohet rregulli “normal” i pjesës më të madhe.

2.2.2. Përcaktimi i origjinës për produktet që nuk janë përfshirë në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD

Për mallrat që nuk janë të listuara në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD origjina përcaktohet rast pas rasti duke vlerësuar çdo proces ose operacion në lidhje me konceptin e ndryshimit ose përpunimit të fundit thelbësor siç përcaktohet në nenin 60, të KD.

Nuk ekzistojnë rregulla ligjore të detyrueshme për produktet që nuk janë të listuara në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD.

Për mallrat që nuk janë të listuara në Aneksin 22-01, të shtojcës A, të DZKD, operacionet minimale të përmendura në nenin 101, të DZKD, nuk duhet të konsiderohen për qëllime të dhënies së origjinës.

Në përputhje me nenin 100, paragrafi 3, të DZKD kur operacionet e punimit ose përpunimit nuk justifikohen ekonomikisht, vendi i origjinës së produktit përfundimtar është vendi ose territori ku e ka origjinën pjesa më e madhe e materialeve, siç përcaktohet në bazë të vlerës së të gjitha materialeve të përdorura.

2.3. Kontrolli i origjinës së deklaruar dhe prova e origjinës

Origjina jo-preferenciale e mallrave është një element i detyrueshëm i deklaratës doganore për çlirimin në qarkullim të lirë.

Deklaruesi është përgjegjës për përcaktimin e saktë të origjinës dhe duhet të ruajë informacionin mbi përpunimin që ka ndodhur në vendin e fundit të prodhimit të mallrave të deklaruara për çlirim në qarkullim të lirë në Shqipëri. Ky informacion duhet të mundësojë përcaktimin e origjinës dhe mund të përfshijë detaje, sipas rastit, mbi produktin tërësisht të përfutur, mbi procesin e saktë të prodhimit dhe mbi klasifikimin tarifor, vlerën dhe origjinën e materialeve të përdorura.

Prova e origjinës është e gjithë dëshmia e paraqitur për të mbështetur origjinën e deklaruar. Me përjashtim të certifikatës së origjinës për produktet që iu nënshtrohen rregullimeve të veçanta jo-preferenciale të importit, kjo dëshmi nuk i nënshtrohet ndonjë kushti specifik, pra zbatohet parimi i provave të lira. Provat nuk duhet të paraqiten automatikisht në kohën e dorëzimit të deklaratës për çlirim në qarkullim të lirë, por duhet të vihen në dispozicion të autoriteteve doganore me kërkesën e tyre. Prandaj, operatori ka interes të sigurohet se i ka të gjitha informacionet e nevojshme në posedim të tij në kohën e depozitimit të deklaratës për çlirim në qarkullim të lirë.

2.3.1. Certifikata e origjinës për produktet shqiptare në eksport dhe bashkëpunimi administrativ

Certifikatat e origjinës jo-preferenciale, për produktet që e kanë origjinën e tyre në Republikën e Shqipërisë (neni 61, i KD), lëshohen nga Dhomat e Tregtisë dhe të Industrisë, mbi bazën e një kërkesë me shkrim nga personi i interesuar, me kusht që origjina e produkteve të jetë përcaktuar në përputhje me nenin 60, të KD. Certifikata e origjinës jo-preferenciale lëshohet duke përdorur formularin e paraqitur në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në aneksin 22-09, të shtojcës B, të DZKD. Shih linkun: <http://uccial.al/index.php/pajisje-me-certifikate-origjine/>

Kur e justifikojnë rrethanat, veçanërisht kur i interesuari ka aktivitet të rregullt eksporti, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë mund të vendosë të mos kërkojë paraqitjen e një kërkesë për çdo operacion eksporti, me kusht që të respektohen dispozitat në fuqi përse i përket origjinës.

Kur e justifikojnë nevojat tregtare, mund të lëshohet një ose disa kopje shtesë të certifikatës së origjinës.

Në kuadrin e bashkëpunimit administrativ me vende të tjera, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë lëshuese të certifikatave të origjinës do t'u përgjigjen kërkesave të autoriteteve kompetente doganore të vendit ku janë importuar mallrat për kontrolle a-posteriori, qoftë edhe nëpërmjet autoriteteve doganore shqiptare.

Rezultatet e kontrollit a-posteriori duhet t'u komunikohen autoriteteve kërkuese sa më shpejt që të jetë e mundur. Koha maksimale për përgjigje nuk duhet të kalojë 6 (gjashtë) muaj.

2.3.2. Kontrolli i origjinës jo-preferenciale për produktet që nuk i nënshtrohen rregullimeve të veçanta jo-preferenciale të importit

Kurdo që autoritetet doganore duan të verifikojnë origjinën jo-preferenciale të deklaruar, bazuar në nenin 61, të KD, mund të kërkojnë nga deklaruesi që të provojë origjinën e mallrave.

Në rast se deklaruesi është mbajtës i një vendimi IDO, duhet ta tregojë atë në deklaratën për çlirim në qarkullim të lirë dhe duhet të provojë që mallrat e importuara janë të njëjta me mallrat për të cilat është lëshuar IDO-ja.

Mund të kërkohet informacioni dhe dokumentat e mëposhtme (listë jo-shteruese):

- emri dhe adresa e prodhuesit;
- shteti dhe vendi i prodhimit;
- dokumentat doganore të vendit eksportues;
- kontratat tregtare të shitjeve;
- çdo informacion ose dokument tjetër që provon origjinën e mallrave në bazë të nenit 60 të kd.

Informacioni në lidhje me origjinën e mallrave:

- përshkrimi i produktit;
- klasifikimi tarifor (minimimi 6 shifror);
- çmimi ex-works/çmimi i fabrikës;
- origjina:

Shpjegim se si është bërë vlerësimi i origjinës së deklaruar të produktit (cila nga dispozitat e Kodit Doganor dhe të Dispozitave Zbatuese të tij janë zbatuar?)

Informacion në lidhje me përcaktimin e origjinës:

- përshkrim i detajuar i procesit të prodhimit;
- a është prodhuar ky produkt nga materialet që janë përfunduar tërësisht në vendin e prodhimit?

Nëse jo, duhet të jepen elementët e mëposhtëm:

- a) kur përcaktimi i origjinës bazohet në një ndryshim në klasifikimin tarifor, për secilën prej materialeve ose përbërësve:
 - i. nënkrahjet ku ato janë klasifikuar (6 shifror);
 - ii. origjina

- b) kur përcaktimi i origjinës bazohet mbi rregullin e vlerës së shtuar, jepet vlera e komponentëve më të rëndësishëm që nuk origjinojnë në vendin e prodhimit, duke lejuar verifikimin se rregulli është përmbushur.
- c) kur origjina përcaktohet nga ndonjë metodë tjetër (e tillë si një operacion specifik përpunimi ose një rregull i mbetur), jepet informacion i hollësishëm (sipas rastit: pesha, vlera e materialeve, etj), duke lejuar verifikimin se rregulli është plotësuar.

Aneksi 1, i këtij manuali udhëzues është një formular i cili përfshin këto elemente dhe mund të plotësohet nga deklaruesi sipas kërkesës së autoritetit doganor. Ky Aneks është menduar thjesht si një shembull dhe nuk ka forcë detyruese. Kur informacioni që përmban formulari duhet të mbahet konfidencial, ai mund të dërgohet direkt tek zyra doganore e treguar në Aneks.

Certifikata e origjinës e lëshuar në vendet e treta

Autoritetet doganore nuk duhet të kërkojnë një certifikatë origjine të lëshuar nga një vend i tretë si një provë origjine, me përjashtim të rastit për produktet që i nënshtrohen një marrëveshjeje të veçantë jo-preferenciale të importit të përcaktuar në Aneksin 22-14, të Shtojcës B, të DZKD, e cila trajtohet më poshtë në pikën 2.3.3.

Kur certifikata e origjinës e lëshuar nga vendet e treta paraqitet bashkë me deklaratën për çlirim në qarkullim të lirë, për raste të tjera nga ato të përmendura në nenet 104-106 të DZKD, ajo nuk vërteton origjinën bazuar në nenin 60 të KD. Një provë e tillë origjine nuk jep informacion për saktësinë e origjinës jo-preferenciale të deklaruar, përderisa vendet e treta mund të kenë rregulla të ndryshme. Prandaj, kjo lloj certifikate thjesht tregon për vendin e prodhimit ose të prejardhjes së mallrave. Përveç kësaj, asnjë bashkëpunim administrativ nuk është parashikuar për këtë lloj certifikate të origjinës.

Për më tepër, prova e origjinës e lëshuar për qëllime preferenciale, madje edhe në kontekstin e një marrëveshjeje tregtare preferenciale ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të tretë, në parim nuk është e pranueshme si provë origjine jo-preferenciale e mallrave në fjalë, pasi rregullat e origjinës të zbatueshme në secilin rast janë të ndryshme. Megjithatë, prova e origjinës preferenciale mund të merret në konsideratë në verifikimin e origjinës jo-preferenciale të deklaruar, nëse deklaruesi mund të vërtetojë se mallrat në fjalë kanë fituar statusin e tyre të origjinës preferenciale bazuar në rregullat e njëjta me ato që zbatohen për të përcaktuar vendin e origjinës, në përputhje me nenin 60 të KD.

2.3.3. Verifikimi i origjinës jo-preferenciale për produktet që janë subjekt i marrëveshjeve të veçanta jo-preferenciale të importit (neni 61, pikat 1 dhe 2 të KD)

Produktet që i nënshtrohen rregullimeve të veçanta jo-preferenciale të importit janë produkte për të cilat kuotat tarifore hapen në përputhje me legjislacionin shqiptar, i cili në mënyrë specifike parashikon detyrimin për të paraqitur një provë origjine në formën e certifikatës së origjinës jo-preferenciale, siç përcaktohet në nenin 104, të DZKD për të përfitur nga niveli i reduktuar i tarifës kur mallrat në fjalë çlirohen në qarkullim të lirë.

Formulari i certifikatës së origjinës jepet në Aneksin 22-14, të Shtojcës B të DZKD.

Në rast dyshimesh të arsyeshme ose kontrollesh rastësore, verifikimet e këtyre certifikatave të origjinës kryhen në përputhje me nenin 106, të DZKD. Për qëllim të verifikimit a-posteriori të këtyre certifikatave, duhet të krijohet një procedurë e bashkëpunimit administrativ, siç parashikohet në nenin 105, të DZKD. Lidhur me këtë, vendet e treta duhet t'i sigurojnë Shqipërisë:

- emrat dhe adresat e autoriteteve lëshuese, bashkë me specimenet e vulave të përdorura për miratimin e certifikatave nga këto autoritete;
- emrat dhe adresat e autoriteteve qeveritare përgjegjëse për verifikimin a-posteriori.

Kur ky informacion nuk sigurohet, autoritetet kompetente shqiptare, refuzojnë përdorimin e marrëveshjes së veçantë jo-preferenciale të importit.

Nëse nuk ka përgjigje për kërkesën e verifikimit brenda gjashtë muajsh pas dërgimit të saj, autoritetet doganore duhet të refuzojnë përdorimin e marrëveshjes së veçantë jo-preferenciale të importit për produktet në fjalë.

2.3.4. Deklarimi i pasaktë i origjinës jo-preferenciale në deklaratën për çlirim në qarkullim të lirë

Kur origjina jo-preferenciale e deklaruar është e pasaktë, neni 354, pika 4 e DZKD parashikon se, origjina që do të merret parasysh për llogaritjen e shumës së detyrimeve të importit do të përcaktohet në bazë të provave të paraqitura nga deklaruesi ose, kur kjo nuk është e mjaftueshme ose e pranueshme, në bazë të çdo informacioni të disponueshëm.

3. Eksporti i mallrave

Rregullat jo-preferenciale të origjinës së Republikës së Shqipërisë zbatohen në raste shumë specifike dhe të kufizuara për eksportin e mallrave. Ato bazohen vetëm për mallrat e eksportuara kur ekzistojnë masa të Republikës së Shqipërisë në lidhje me origjinën e mallrave, si për shembull rimbursimet e eksportit. Rimbursimet e eksportit mund të jepen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Për mallrat e tjera të eksportuara, të cilat janë shumica e rasteve, nuk është e detyrueshme të përdoren rregullat jo-preferenciale të origjinës së Republikës së Shqipërisë. Përveç kësaj nuk është e detyrueshme të tregohet origjina në deklaratën doganore të eksportit.

Përveç situatës ku zbatohen masat e Republikës së Shqipërisë, dispozita e vetme ligjore për origjinën jo-preferenciale për eksportin është pika 3, e nenit 61, të KD, e cila lidhet me lëshimin e një dokumenti që vërteton origjinën. Ajo thekson se kur e kërkojnë nevojat e tregtisë, një dokument që provon origjinën mund të lëshohet në Republikën e Shqipërisë në bazë të rregullave të origjinës në fuqi në vendin e destinacionit, ose duke aplikuar ndonjë metodë tjetër që identifikon vendin ku mallrat ishin tërësisht të përfuara, ose që kanë pësuar transformimin e fundit thelbësor.

Një mjet i dobishëm për operatorët ekonomikë për të gjetur nëse një vend i tretë zbaton rregullat jo-preferenciale të origjinës mund të jenë *njoftimet e anëtarëve të OBT për zbatimin e rregullave jo-preferenciale të origjinës* (Notifikimet) Duhet të theksohet se kjo listë ndryshon.

ANEKSI 1

Informacioni që mund të kërkohet nga autoritetet doganore

Referenca në deklaratën doganore për çlirimin në qarkullim të lirë:

Identifikimi i deklaruesit:

Informacioni në lidhje me origjinën e mallrave:

1. Përshkrimi i produktit;
2. Klasifikimi tarifor (minimumi 6-shifror);
3. Çmimi ex-works/çmimi i fabrikës;
4. Origjina.

Si e keni bërë vlerësimin e origjinës së deklaruar të produktit?

Cilat nga dispozitat e Kodit Doganor dhe të Dispozitave të tij Zbatuese janë zbatuar?

Ju lutemi jepni informacionin e mëposhtëm në lidhje me përcaktimin e origjinës:

1. Përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit;
2. A është prodhuar ky produkt nga materialet që janë përfunduar tërësisht në vendin e prodhimit?
3. Nëse jo, ju lutemi jepni elementët e mëposhtëm:
 - a. Kur përcaktimi i origjinës bazohet në një ndryshim në klasifikimin tarifor, për secilin nga materialet ose përbërësit jepet informacion mbi:
 - nënkrerët ku ato janë klasifikuar (6 shifror);
 - origjina
 - b. Kur përcaktimi i origjinës bazohet në rregullin e vlerës së shtuar, jepet vlera e komponentëve më të rëndësishëm që nuk origjinojnë në vendin e prodhimit, duke lejuar verifikimin që ky rregull është përmbushur.
 - c. Kur origjina përcaktohet nga ndonjë metodë tjetër (e tillë si një operacion specifik përpunimi ose një rregull i mbetur), jepet informacion i hollësishëm (sipas rastit: pesha, vlera e materiale, etj.), duke lejuar verifikimin që rregulli është plotësuar.

Provat në lidhje me këto elemente mund të kërkohen në një fazë të mëvonshme, duke përfshirë kopjet e deklaratave të importit, faturat, etj.

Kur informacioni i mësipërm duhet mbajtur konfidencial, ky dokument mund të kthehet direkt në zyrën doganore përgjegjëse për verifikimin e origjinës së deklaruar, Sektori i Origjinës, në Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës, në adresën e mëposhtme: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Industriale, Pajtoni Center, Kati 5^{te}.

ANEKSI 22-01, i shtojcës A, të DZKD

Shënime hyrëse dhe lista e operacioneve të punimit ose përpunimit thelbësor që japin origjinë jo-preferenciale

Teksti i plotë mund të gjendet këtu:

<https://dogana.gov.al/dokument/3021/aneksi-22-01-shtojca-a>

ANEKSI 22-09, i Shtojcës B, i DZKD

Certifikata e Origjinës

Formulari mund të gjendet këtu:

<https://dogana.gov.al/dokument/3022/aneksi-22-09-shtojca-b>

ANEKSI 22-14, i Shtojcës B, të DZKD

Certifikata e origjinës për produktet që janë objekt i marrëveshjeve/rregullimeve të veçanta të importit të origjinës jo-preferenciale

Teksti i plotë mund të gjendet këtu:

<https://dogana.gov.al/dokument/3278/re-aneksi-22-14-shtojca-b>